

Rekomandime

“ Ne se do te kishim sistem me te mire arsimor do te kishte me pak Rome ne shkollat speciale”

Psikolog, shkolle speciale ne Serbi me nxenes, Rome 80%

Qe te behet realitet aspirata “fushe loje e barabarte” per femijet Rome, Jevgjite dhe Endacake, qeverite luajne nje rol shume te rendesishem per te ndryshuar politikat dhe praktikat ne nivelin kombetar sistematik. Konstatimi me zhgenjyes ne raportet me titull, *Pse te mohohet nje e ardhme*, eshte sa pak ndryshime kane ndodhur ne disa vende ne 10 vjeçarin e fundit. Pavaresisht nga qindra projekte te sukseshme qe jane zhvilluar ne shkolla te veçanta dhe ne kopshte, ajo qe vihet ne dukje eshte çfare lloj ndryshimi duhet bere. Ky problem eshte trajtuar vazhdimisht dhe eshte vene re se kur mesuesit jane te pergatitur mire dhe i kane te gjitha resurset arsimore per te cilat kane nevojë ata mund te punojne me femije nga te gjitha sferat e shoqerise. Po keshtu, ka disa politike-beres qe akoma besojne se shkollat e ndara jane favor per femijet qofshin keta nga grupe minoriteti ose nga shumica e popullsisë. Vetem qeverite mund te kryejne ndryshime sistematike qe ne fund te fundit do te sigurojne te drejten per arsim per femijet Rom, Jevgjite dhe Endacake. Fillimet e ketyre ndryshimeve vihen re tashme ne disa vende. Megjithate shume nga keto iniciativa kane filluar vetem kohet e fundit, keshtu qe vleresimi eshte bere vetem per nje grup te vogel femijesh.

Drejtoret e shkollave, mesuesit, drejtuesit e komunitetit dhe organizatat jo-qeveritare luajne gjithashtu nje rol shume te rendesishem. Qeverite nuk jane te plotfuqishme dhe shume nga ndryshimet qe duhen bere varen nga puna e individeve ne shkolle dhe nga komunitetet qe veprojne per te bere ligjin dhe politiken, nje realitet.

Organizatat nderqeveritare kane nje detyre te rendesishme per te mbeshtetur qeverite ne monitorimin dhe vleresimin e ketyre ndryshimeve. Ne veçanti, agjensite qe planifikojne dhe menaxhojne fondet e bashkimit Evropian duhen te sigurohen se programet qe ato mbeshtesin dhe qe do te krijojne ndryshime, te jene strategjike dhe te besueshme.

Se fundi, media, luan nje rol jetesor per te transmetuar mesazhin dhe per te garantuar te drejtat e femijeve nga minoritetet qe deri tani u eshte mohuar nje e drejte ne krahasim me femijet e tjere. Te gjithë femijet perfitojne kur rriten ne nje shoqeri qe respekton te drejtat e te gjithë qytetareve te saj. Per kete arsye ndersa shume rekomandime jane pergjegjesi e qeverive te vendit, detyra per zbatimin e tyre na takon te gjithëve.

Detyra qe shtrohet para qeverise

“Neqoftese do te ishe minister arsimi per nje dite çfare ndryshime do te beje ne sistemin arsimor per te zhvilluar arsimin per popullsinë Rome?”

“ Une do te preferoja te isha minister i finances per te caktuar para per ta zbatuar ate si duhet”.

Studente Rom universitar, Rumani

Kerkohe angazhim afat gjate nga ana e qeverise jo vetem per te hartuar reforma qe kane per synim zhdukjen e diskriminimit por gjithashtu per te siguruar qe sistemi arsimor te monitorohet sa me mire dhe te vleresojte rezultatet. Pervec masave qe kane per qellim zhdukjen e diskriminimit ne arsim, duhet te ndermerren aksione urgjente per te trajtuar kete problem mbi bazen e te drejtes etnike ne tregun e punes. Sfida qe ndeshin politike beresit eshte te siguroje qe politikanet te mos i manipulojne keto perpjekje per te rritur zemerimin e pjeses me te madhe te popullsisë duke krijuar keshtu pershtypjet se grupet e shumices dhe grupet e minoritetit jane angazhuar ne nje lufte te vazhdueshme per burime. Ne nje numer te vogel vendesh qeverite duhet te adoptojne nje legjislacion efikas kunder diskriminimit. Rekomandimet e dhena ne raportet e vendeve te ndryshme theksojne kete aspekt te vecante te reformes legjislative ne republiken Çeke, Sllovaki, Hungari dhe ne kohen e perpilimit edhe ne Rumani, ku ky proces kishte avancuar mjaft mire. Greqia duhet te firmose Kartën Evropiane per Gjuhët Minoritare dhe Konventa e UNESCO kunder diskriminimit ne arsim dhe gjithashtu duhet te ratifikoje konventen per mbrojtjen e pakicave kombetare. Maqedonia, Rumania dhe Mbreteria e Bashkuar duhet te ratifikoje Kartën Evropiane per gjuhët minoritare.

Pothuajse ne te gjithë vendet mungojne te dhena te sakta per numrin e femijeve Rome, Jevgjitë dhe Endacake qe ndjekin shkollen dhe mungojne gjithashtu te dhenat per arrijtet e tyre ne shkolle. Duke u nisur nga qellimet e grumbullimit te ketyre te dhenave per keto grupe etnike, qeverite jane te shqetesuara se qellimet e tyre te mira mund te keq interpretohen megjithate mungesa e te dhenave e veshtireson punen e monitorimit dhe krijon mundesi qe keto te dhena te mbeten thjesht si evidence anekdotash.

Detyra qe shtrohen perballe shoqerise civile

“Prinderit e femijeve jo Rome jane kunder konceptit qe femijet e tyre te qendrojne ne nje klase me femijet Rome. Ata thone se me mire preferojne ti vrasin femijet e tyre se sa te ulen ne banka me femijet Rome”.

Prind Rom ne Kroaci

Çeshtja per mundesi te barabarta eshte e padiskutueshme. Qeverite e vendeve qe kane marre pjese ne perpilimin e raporteve pse te mohohet nje e ardhme , e njohin kete fakt duke nenshkruar dhe ratifikuar ligjerisht konventa dhe Karta Nderkombetare.

Megjithate ne disa vende Evropiane klima politike eshte e ketille qe masat qe ne dukje tentojne te favorizojne grupet e komuniteteve, shpesh behen pre e manipulimeve e politikaneve oportuniste te cilet perpiqen te fitojne mbeshtetje elektorale duke luajtur me friken qe kane prinderit nga shumica e popullates se integrimi me femijet e minoritetit do te ndihmonte femijet e tyre. Media dhe organizatat joqeveritare luajne nje rol te rëndesishem mbi ndergjegjesimin publik mbi kostot sociale dhe ekonomike mbi ruajtjen e pabarazive duke mbeshtetur qeverite ne perpjekjet e tyre per ti dhene fund diskriminimit dhe per te siguruar mundesi te barabarta arsimore per femijet Rom, Endacake dhe Jevgjitë.

Detyre ne nivel nderqeveritar

“ Eshte nje term i eger termi ndarje por disa kolege te mi mendojne se do te ishte me mire sepse ata mesojne ne menyren qe duan dhe jo te rrezikuar nga armiqesia qe ka per ta shumica e nxenesve. Por politika zyrtare eshte kunder saj dhe synon t’i integroje ata ne shoqeri”

Perfaqesues i Ministrise se arsimit – Hungari

Duhet njohur fakti se shume nga ndryshimet pozitive te filluara nga qeverite keto vitet e fundit mund te mos kishin ndodhur dhe mund te mos ishin konsideruar si prioritet pa presionin e ushtruar nga institucionet nderkombetare dhe Evropiane. Institucionet nderqeveritare, do te vazhdojne te luajne nje rol te rendesishem per t’iu kujtuar gjithmone qeverive detyrimet qe ata kane lidhur me standartet per te cilat kane rene ne marreveshje ne plan nderkombetar dhe keto institucione gjithmone do te mbeshtesin qeverite per ti permbushur keto standarte.

Per te ardhmen e parashikueshme, Bashkimi Evropian dhe Keshilli i Evropes duhet te vazhdojne te monitorojne ndryshime ne politiken arsimore per popullaten Rome, Jevgjite dhe Ednacake ne te gjithe Evropen. Ne nje te ardhme te aferme do te kerkohen fondet e nevojshme per te mbeshtetur ngritjen e sistemeve dhe praktikave te reja dhe per te perhapur praktiken me te mire ne nivel Evropian dhe ne ate Kombetar.

- **Organizatrat nderkombetare duke perfshire Komisionin e Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Njeriut, Raportuesi special per format bashkekohore te racizmit, diskriminimit racial, ksenofobise dhe intolerances, dhe Komisioni Evropian kunder racizmit dhe intolerances duhet te vazhdojne te monitorojne nga afer obligimet nderkombetare te ndermarra nga qeverite lidhur me te drejten per arsim duke vene theksin vecanerisht mbi te drejten e arsimit per femijet Rom, Endacak, dhe Jevgjit.**

Ne shume vende Evropiane, sistemet arsimore jane projektuar sipas nevojave te pakices dhe jo te shumices.

“ Kjo metode autoritare Prusiane nuk eshte e keqe vetem per femijet Jevgjite por per te gjithe femijet.”

Specialist ne fushen arsimore - Hungari

- Me qellim qe te rritet besimi ne sistemet arsimore, arsimi formal duhet te jete gjithepershires dhe te plotesoje nevojat e te gjithe femijeve. Nje sistem i tille arsimor me siguri çon drejt mundesive te punesimit. Komunitetet Rome, Jevgjite dhe Endacake do te kene me shume besim dhe do te perdorin me shume shkollat kur keto tregojne respekt, per historine, kulturen, arritjet dhe aspiratat e tyre.

Vizion me i gjere dhe modele brenda shkollave do te rrisin besimin

“ Ketu ku banoj une prej 50 vjetesh, asnje femije Rom nuk kishte shkuar ne kolegji. Kur une fillova te shkoj motra ime u bashkua me mua. Njerezit e tjere e pane se kjo ishte nje zgjedhje realiste dhe tre vitet e fundit, gjashte femije kane shkuar ne kolegji”.

Student Rom, ne kolegji – Hungari

Nje aspekt baze per te demonstruar gjithepershirje, eshte te sigurohemi qe femijet Rom, Jevgjite dhe Endacake, te jene fizikisht prezent dhe te konsiderohen si modele Rom dhe perfaqesues te komuniteteve te tyre ne shkollat – si prinder, asistente dhe mesues.

- Ndihet nevojte urgjente per me shume mesues, per ti mesuar asistentet dhe asistentet e klasave, kryesisht ata te marre nga komunitetet Rom, Jevgjite dhe Endacak qe te krijojne lidhje dhe te dialogojne midis shkollave dhe komuniteteve qe ata i sherbejne.
- Kurse pranimi me orar fleksibel per studente qe e kane nderprere shkollen do tu jape mundesi nxenesve te pjekur dhe atyre me pergjegjesi familjare te pergatiten si asistente ne procesin e mesimdhënies dhe mesues. Ne disa raste do te nevoiten masa te metejshme si per shembull bursa dhe kopshte dhe çerdhe me pagese qe trainimi ose ritrainimi te behet nje aspirate realiste.

Hapja e shkollave ne komunitete

“ Femijet nuk duhet te rrine te ngjeshur me njeri tjetrin ne nje klase te vogel. Duhet ndertuar nje vend per femijet”

prind Rom- Rumani

- Ne shume vende godinat e shkollave dhe kopshteve kane mjaft vend per shkak te uljes te ritmit te lindjeve. Kjo hapësire e paperdorur duhet shfrytëzuar ne menyra krijuese per te ngritur godina qe do te perdoren nga komuniteti, per shembull, klinika shendetesore te komunitetit, qendra keshillimore per qytetaret, çerdhe dhe kopshte, qendra per mesimin e te rriturve dhe per pergatitjen e njerezve per te patur shprehi te reja ne pune.
- Godinat e shkollave duhet te perdoren ne menyre me efikase per tu ofruar femijeve dhe te rinjve aktivitete jasht-shkollore dhe ne fund jave si dhe per te krijuar mundesi, pjesmarrjen e antareve te familjes ne ambientin e shkolles. Vemendje e veçante i duhet kushtuar nevojave te femijeve qe jetojne ne ambiente te vogla me shume pjestare ne familje dhe me kushte jetese te varfere dhe qe e kane shume te veshtire per te studiuar ne shtepi.

Merni seriozisht shqetesimet e prinderve dhe femijeve

" Ata te gjithë heqin dore nga shkolla ne fund, nje vajze mbaroi kolegjin ku mundi te gjeje pune dhe u kthye perseri ne fshat".

Nene Rome- Hungari

Ne shume komunitete Rom, Evgjite dhe Endacake eshte e qarte se shume prinder nuk jane te bindur qe arsimi ofron mundesi te mira ekonomike. Dhe per familjet qe jane ne gjendje t'u ofrojne nje shkollat femijeve, a ja vlen te sakrifikosh fitimet ekonomike qe burojne nga puna qe femijet mund te bejne tani dhe te presesh fitimet afatgjata qe mendohet qe do te kete familja pasi te kete mbaruar femija shkollen? Sa realiste jane

aspiratat dhe sa te dobishme jane kualifikimet kur racizmi institucional vazhdon dhe ne vendet e punes?

" Une nuk mund t'i furnizoj ata me libra dhe me veshje. Femijet me te rritur duhet te kujdesen per ata me te vegjelit sepse une dhe gruaja punojme, prandaj siç e shihni ketu nuk ka vend per te studjuar".

Prind Rom -Bosnje -Hercegovine

" Besoj se ata kane nje çmim per te paguar (asimilimi) keshtu ata preferojne ta lene shkolle)".

Jane G Lee cituar ne raportin me titull *Pse te mohohet nje e ardhme?*

" Ata te japin vleresimin C ne se di ose nuk di me qellim qe te heqin qafe. Ka nxenes qe nuk dine akoma te lexojne ne klasen e peste. Mesuesja i dergon te bejne pazar per te dhe nxenesi nuk ka pse te kthehet me ne shkolle".

Nxenes shkolle Rom, 13 vjeç - Bullgari

- Duhet bere me shume pune kerkimore per te kuptuar me qarte rolet respektive te faktoreve ekonomike, sociale, dhe kulturore per faktin pse largohen femijet nga shkolla me deshire ose jo.
- Duhet bere me shume pune kerkimore per te kuptuar ndikimin qe luan diskriminimi dhe praktika e dobet mesimore per motivimin dhe arritjet e nxenesve Rome, Jevgjite dhe Endacake.
- Konsultimi dhe perfshirja e prinderve dhe femijeve eshte metoda me efikase per te identifikuar pengesat qe dalin per frekuentimin dhe arritjet dhe duhen zhvilluar strategji per trajtimin e ketyre problemeve.
- Vemendje e veçante i duhet kushtuar pikpamjeve dhe nevojave te familjeve ku prinderit, femijet e vegjel dhe bashkemoshataret nuk kane ndjekur fare shkolle ose e lene shkollen heret dhe te cilet kane problem me asimilimin nga femija e tyre te kultures se shumices kunder deshirave te tyre.
- Konsultimi dhe perfshirja aktive e antareve te komunitetit do te jete thelbesor per te zhvilluar sherbime ose per te pershtatur praktika qe te permbushin nevojat e komunitetit me nje stil jete te veçante ose me preferenca kulturore te tilla si komunitetet tradicionale ose komunitetet qe udhetojne nga vendi ne vend gjate gjithë vitit ose nje pjese te vitit.

Femijet kane nevojë për një ambient të sigurt

"Shkolla e mesme qe une shkoja ishte nje tmerr i vertete. Ne nuk kishim kohe as per te lexuar dhe as per te shkruar sepse te tjeret na peshtynin , na ngacmonin dhe na keqtrajtonin. Keta ishin nxenes dhe shumica e mesuesve".

Endacake - Skoci

" Femijet e mi nuk shkojne ne shkollë. Une nuk ndihem e sigurt t'i lejoj ata qe te ndjekin shkollën ne J dhe ata jane teper te vegjel dhe nuk mund te ecin distanca te gjata deri ne O. Le te hapin nje shkollë ketu ne fshat, te organizojne transportin per femijet me te rritur dhe atehere une mund t'i dergoj ata ne shkollë. Tani une ndihem e pasigurt t'i lejoj ata te vazhdojne shkollën" .

Nene Rome me tre femije ne moshe shkollore - Bosnje - Hercegovine

- Gjithashtu edhe ne raportin me titull *Pse te mohohet nje e ardhme?* jane ngritur shqetesime per sigurimin e femijeve. Kerkohen perpjekje edhe me te dukshme per ta bere shkollën vend ku te gjithë femijet te ndihen te sigurt nga abuzimi fizik dhe verbal.
- I gjithë komuniteti i shkolles duhet te angazhohet per te zhvilluar strategji per te trajtuar abuzimin fizik, verbal dhe ngacmimet per shkaqe racore.
- Ne çdo raport te te gjitha vendeve eshte ngritur shqetesimi per friken ndaj sigurise se femijeve kur ata shkojne ne shkollë. Autoritetet e shkolles dhe ato bashkiake duhet te vendosin nje dialog me femijet dhe prinderit per te zhvilluar strategji lokale per trajtimin e ketyre shqetesimeve.

" Vajza ime me thote : Une nuk do te shkoj me ne ate shkollë.....E si mendoni ju, si mund t'i mbaj femijet e mi ne shkollë? Dhe ju nuk do te lejonit qe femija juaj te shahet çdo dite me fjale".

Nene Skoceze Endacake

Prinder qe marrin guximin te shprehen hapur do te kene besim ne veten e tyre kur ata te bejne zgjedhjet e duhura per shkollimin e femijeve te tyre. Per shembull:

- Prinderit duhet te jene ne gjendje te kerkojne nga shkolla ne se mesuesit e asaj shkollë jane te pergatitur per te trajtuar te gjithë femijet njelloj. Neqoftese mesuesit ne nje shkollë nuk e kane marre kete lloj trajtimi per trajtim te barabarte te tyre atehere prinderit duhet te kene te drejte te kerkojne nje shkollë alternative ku mesuesit te kene marre trajnimin dhe shprehite e duhura.

Mesuesit duhet te kene trainim dhe burime me te mira

" Eshte e vertete qe ne kemi nevojë per trainim nderkulturor te mesuesve. Mesuesit nuk dine se çfare te bejne. Ata ose nuk kane eksperience ose jane shume autoritare ndaj nxenesve Jevgjite".

Arsimtar-Hungari

Perveç dhunimeve te hapura te te drejtave te njeriut qe jane evidentuar ne shume vende raportet me titull *Pse te mohohet nje e ardhme?* tregojne se rezultatet diskriminuese lindin nga kurrikula shkollore e hartuar keq dhe nga mesues qe pamvaresisht nga qellimi i tyre i mire nuk jane trainuar si duhet dhe kane burime dhe eksperience te pakët.

Ne shume vende paaftesia nga ana e stafit mesimor per te punuar me femije me origjina te ndryshme sjell si pasoje qe shume mesues te kene rezultate te ulta dhe pak shpresa ne punen e tyre me femije Rome, Jevgjite dhe Endacake. Keto pikpamje shpesh u komunikohen femijeve dhe shoqeve te tyre te klases. Mungesa e referencave per jeten e femijve Rome, Jevgjite dhe Endacake ne shume tekste mesimore e veshtireson akoma me shume problemin.

Kerkohe me shume pune nga ana e Ministrive te Arsimit dhe institucioneve qe pergatisin mesues per te siguruar qe mesuesit e fillojne profesionin e tyre ne te gjitha aftesite qe duhen per te punuar me gjithe femijet.

- Te drejtat e femijeve, te drejtat e njeriut dhe trainim me mundesi te barabarta duhen te perfshihen si elementa te domozdoshem ne programet metodike per pergatitjen e mesuesve dhe per mesues qe jane ne profesion. Kjo gje do t'i jape mundesi mesuesve te identifikojne dhe te trajtojne incidente me karakter racist.
- Pergatitja e mesuseve ne shkolle dhe gjate punes se tyre ashtu siç eshte formuluar ne program duhet te siguroje qe te gjitha mesuesit te njohin mire shprehite dhe metodat qe kerkohen per te punuar me femije nga grupe te ndryshme etnike, gjuhesore, fetare dhe kulturore.
- Historia, kultura dhe gjuha e komunitetit Rome, Jevgjite dhe Endacake duhet te studiohet nga te gjitha mesuesit ashtu siç mesojne gjuhete dhe kulturen e vendit nepermjet moduleve.
- Udhezime te mira praktike per mundesi te barabarta ne arsim qe tashme ekzistojne duke perfshire edhe mjetet e vetvleresimit dhe udhezimet per inspektoret e shkollave duhen perhapur tek mesuesit me qellim qe ato te pershtaten dhe adoptohen nga ato vende ku keto udhezime dhe mjete nuk perdoren tashme.
- Te gjitha referencat me nuance tallese ndaj Romeve, Jevgjiteve dhe Endacakeve duhet te hiqen nga tekstet shkollore.
- Tekstet shkollore dhe materialet me permbajtje historike duhet te perfshijne referenca per grupet etnike dhe te minoriteteve te tjera me nje tendence pozitive, ne nje menyre te ballancuar dhe te reflektojne gjithe kuadrin fetar dhe gjuhesor ashtu siç shfaqet ky problem ne vendin perkates ose ne nje kontekst me te gjere Evropian.

Projektimi i Arsimit ne perputhje me ralitetin jetesor te femijeve

" Une shkoj ne shkolle kur nuk kam per te bere pune ne shtepi ose kur nuk me duhet te kujdesem per vellezerit dhe motrat me te vegjel".

Vajze Rome 9 Vjeçe - Greqi

Realiteti jetesor i shume femijeve shpesh lihet pas dore kur hartohen projekte ne fushen arsimore dhe kur hartohen programet. Te jesh nje prind i ri dhe te kesh nevojte per pune sepse mban pergjegjesi familjare nuk do te thote qe automatikisht te perjashtohesh nga e drejta per tu arsimuar.

" Me vjen keq qe nuk kam ndjekur asnjehere shkolle. Nuk mund te shkoja ne shkolle pasi isha femija me i madh ne familje.".

Nje aktivist Rom, 22 vjeçar, i cili i percjell femijet Rom ne shkolle nga vendbanimet e tyre- Mai i Zi.

- Duhet hartuar nje kurrikul fleksibel per te plotesuar kerkesat e prinderve te rinj dhe femijeve me te rritur te cilet punojne ose kane pergjegjesi familjare.
- Eshte e nevojshme te behen kerkime te metejshe me te vleresuar ne se specializimi i hershem ndikon per te futur femijet e afte ne rrjedhen e femijeve jo-akademike me nje ndikim disproporcional per femijet me te varfer dhe per ata nga grupe etnike te minoritetit.

Arsimi profesional duhet te krijojte mundesi per pune reale.

" Dua te behem tregetar dhe te shes karrike. Nuk dua te shkoj ne shkollen e mesme sepse dua te punoj dhe te fitoj para."

Djale Rom, 11 vjeç - Greqi

- Arsimi profesional qe u ofrohet nxenesve me te rritur duhet te çojte ne prespektiva reale punesimi dhe duhet te ofrojte alternativa qe te kete nje permbajtje akademike. Disa studente preferojne lendet profesionale per arsye se ndihet nevojte urgjente financiare nga ana e tyre. Por kjo nuk duhet t'u mbylle atyre preferencat e tjera per te zhvilluar dhe ndjekur interesa akademike me vone, gjate jetes se tyre.

Njohja dhe respekti per gjuhen dhe kulturen Rome, Jevgjite dhe Endacake

" Problem nuk jane femija, problem eshte gjuha".

Mesuese ne Sllovaki

" Mendoj se duhet te kete gjuhe Rome ne shkolle.....mesuesja me trajton mua ndryshe, krejt ndryshe nga te tjeret dhe prandaj une duhet te perpiqem shume."

Djale Rom, 10 vjeç Kroaci

- Sa here te jete e mundur (persa i perket nevojave dhe preferencave te komuniteteve te veçanta dhe fakti se nje ose disa gjuhe dhe dialekte Rome perdoren ne ate komunitet) , gjuha Rome duhet te ekzistojte ne shklolla krahas gjuheve te tjera.

Ndergjegjesimi per te drejtat e njeriut dhe diversitetet qe ne moshe te re

Duke patur parasysh rendesine e arsimit per te transmetuar vlerat qe femijet mbartin ne vetvete gjate gjithë jetes, shkolla duhet te luaje nje rol te rendesishem per te rritur shkallen e ndergjegjesimit dhe per te edukuar ndjenjen e respektit per njerez nga shtresa te ndryshme te shoqerise, me bindje fetare te ndryshme, me gjuhe te ndryshme dhe me zakone kulturore te ndryshme. Raportet me titull *Pse te mohohet nje e ardhme?* vene theksin kryesor mbi efektet qe ka sistemi arsimor per femijet Rom, Jevgjite dhe Endacake i cili eshte hartuar pa dhene asnje reference per eksperiencen e tyre jetesore, per gjuhet dhe kulturat e tyre. Eksperienca e nxenesve Rome, Jevgjite dhe Endacake ne shkolla mund te shihet po te perifrazojme thenien e Vaclav Havel, mund te konsiderohet si nje test baze per te vleresuar ne se sistemi arsimor eshte efikas dhe kontribuon ne krijimin e

nje shoqerie civile. Ne Evropen bashkekohore qe eshte multi raciale, multi kulturore dhe me shume besime, disa elemente jane esenciale per kurrikulen shkollore me qellim qe femijet te mesojne te vleresojne dhe te respektojne shumllojshmerine e identiteteve ne Evrope.

- **Kurrikula Kombetare duhet te perfshije te drejtat e njeriut dhe arsimin qytetar si ne nivelin fillor dhe ashtu ne ate te mesem.**
- **Kurrikula permes te gjithë lendeve qe trajton duhet te permbaje elemente arsimore per te zhvilluar qytetare me pikpamje demokratike dhe me respekt per diversitetin e problemeve.**
- **Nxenesit duhet te kene mundesi te mesojne per te gjitha fete ne bote, per te gjitha gjuhët dhe kulturat dhe te ndergjegjesohen per faktin se edhe qeverite e tyre duhet te respektojne dhe te mbrojne te drejtat e te gjithë qytetareve njelloj, pavaresisht nga besimi, gjuha dhe nga perkatesia etnike dhe kultura.**
- **Nxenesit duhet te mesohen qe te ndiejne nje detyrim ndaj te gjithë qytetareve per te vleresuar dhe respektuar te drejtat e te tjereve qe parashtrohen ne dokumenta qe jane firmosur dhe ratifikuar si konventa nderkombetare.**

Arsimi parashkollor eshte i rëndesishem

Raporti me titull *Pse te mohohet nje e ardhme?* ve ne dukje kontributin e rëndesishem te arsimit parashkollor qe te mos lejoje femijet te mbeten mbrapa ose te mbesin ne klase ne shkollen e tyre fillore. Eshte ndjekur nje praktike dhe politike e mire vitet e fundit dhe ne raportet e vendeve citohen shume shembuj. Shembujt e kesaj praktike te mire kane disa karakteristika te perbashketa siç eshte per shembull, parimi baze qe mund te pershtatet per shume komunitete dhe per shume kultura te ndryshme . Per fat te keq shume nga keto praktika te mira kane mbetur jashte sistemit shtetror dhe perfshirja e tyre ne strukturat e arsimit parashkollor ka qene shume i ngadalshem.

Argumentat per heqjen e arsimit parashkollor falas ose te financuar kane qene kryesisht ekonomike. Megjithate ndryshimi i vene re ne moshat e femijeve qe fillojne dhe e lene shkollen e detyruar ne te gjithe Evropen tregon se pika e nisjes per disa qeveri eshte se ata kane nje obligim per te siguruar arsim falas dhe ky obligim eshte po aq politik sa edhe ekonomik dhe eshte nje vendim qe duhet te merret nga qeverite e vendeve.

" Deri ne vitin 1981 kishte vetem dy kopshte, ketu ne M, njeri ishte ne lagjen e Romeve. Ne vitin 1981 u mbyll kopshti. Kopshti tjetër kercenohej nga i njejtë fakt por autoritetet gjeten nje zgjidhje per ta shpetuar ate. Tani problemi eshte se ky kopesht qe ka mbetur eshte shume larg nga vendbanimi Rom, gjithashtu ka edhe shume femije dhe nje kopesht nuk mjafton".

Mesuese ne nje kopesht ne Shqiperi.

Ne disa vende Evropiane frekuentimi i detyruar ne shkolle dhe pranimi ne shkolle mund te filloje qe ne moshen 4 vjeç ndersa ne disa vende te tjera, jo me pare se 8 vjeç. Vendet qe jane studjuar per te hartuar raportin *Pse te mohohet nje e ardhme?* jane vende me ekonomi te zhvilluara. Per kete arsye vendimi per te dhene arsim falas per disa ose per

te gjithë femijet nën moshën 7 vjeç reflekton pikpamjen ideologjike të shoqërisë lidhur me faktin nëse prindërit ose shoqëria në tërësi duhet të përballojnë koston.

Organizata Save the Children rekomandon që të gjitha qeveritë ta njohin vlerën e arsimit parashkollor duke përfshirë edhe dobiet që i sjell kjo fëmijëve që flasin dy gjuhë. Ata duhet të zhvillojnë strategji që të arrijnë qëllimet e tyre afatgjata.

- Arsimi parashkollor duhet të bëhet i mundur falas për të gjitha familjet që kanë nevojë për të.
- Pagesa për ushqime dhe nevojat tjera që pengojnë disa fëmijë për të ndjekur shkollën ose kopshtin duhen siguruar.
- Në rastet kur është e pamundur të sigurohen pagesat për të gjitha familjet, qeveria duhet të ndërtojë disa procedura për të përcaktuar cilat familje kanë nevojë për këto ndihme duke caktuar familje me nivel analfabetizmi në mënyrë që të ruhet dinjiteti i fëmijëve të tyre që do të marrin këto benefite.
- Në të gjithë sistemin parashkollor, kurrikula duhet bazuar mbi parimet e gjithë përfshirjes dhe të respektimit të diversitetit dhe mund të themi se në të gjithë Evropën Lindore dhe Perëndimore ka shumë shembuj të sukseshëm në këto drejtim.
- Qeveritë e vendeve duhet të ofrojnë mesim dy-gjuhë dhe në gjuhën amtare për ato komunitete që e kërkojnë një gjë të tillë.

Mesuesit asistentë kanë rendesi

"Une flas me tëzën që është asistente Rome dhe ajo shpjegon. Ajo më kupton më mirë, gjithashtu edhe mesuesit na tregojnë se si të bëjmë disa gjëra"

Djalë 6 vjeç Rom që ndjek ciklin përgatitor, Republika Çeke

Raportet e vendeve me titull *Pse të mohohet një e ardhme?* tregojnë se këta asistentë luajnë një rol të dobishëm dhe të rëndësishëm për të mbështetur fëmijet që janë shumë mbrapa po të krahasohen me bashkëmoshatarët e tyre, për shembull ata që nuk janë folës të gjuhës amtare dhe fëmijë që nuk kanë ndjekur asnjehere ciklin parashkollor. Mesuesit asistentë Rome ose Jevgjite apo mediatorët bëjnë punë shumë të mira për të krijuar lidhje midis shkolles, prindërve dhe gjithë komunitetit. Ashtu siç theksohet në raportin e Bullgarisë, këta asistentë duhen përdorur për të mbështetur fëmijet Rome dhe Jevgjite, meqë kjo indirekt mund të nxiti ndarjen, talljet dhe trajtimin e diferencuar. Neqoftese këto do të përdoren si burim në shkollë, ato duhet të jenë për të gjithë fëmijet dhe statusi i tyre profesional, duhet të njihet zyrtarisht.

Në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore ka pak mesues asistentë, veçanërisht, Rome dhe Jevgjite dhe shumica janë të trajnuar, të punësuar dhe paguhet nga Organizatat joqeveritare. Për këto arsye prania e tyre e vazhdueshme në shkollë varet nga fondet jashtë afatshkurtra.

- Roli i rëndësishëm që luajnë mesuesit asistentë në vendosjen dhe funksionimin me sukses të shkollave të integruara dhe multikulturale duhet njohur gjerësisht nga politikbërësit

- Perveç punes që këta mësues asistentë bëjnë si vullnetarë ose trainues, duhet patur parasysh krijimi i postit të asistentit që të njihet profesionalisht dhe të marrë një pagë si ndihmesë mësues në shkollë dhe në kopshtë.
- Për të siguruar statusin e mësuesit profesional duhet të hartohen udhëzime për përmbajtjen e kurrikulës që të njohë kualifikimin e mësuesit asistent.
- Duhet patur parasysh krijimi i një metode të shpejte ku mësuesit Romë dhe Endacake të mbështeten si trainues për të kualifikuar mësues të tjerë dhe që të shërbejnë gjithashtu edhe si mësues në ciklin parashkollor.

Një rast për veprim aprovues

"Kur fillorët të menaxhojnë shkollën isha e tronditur sepse shkolla s'kishte as dritë dhe, as shumë nga klasat nuk kishin dyer dhe ato ekzistueset ishin të thyera, mungonin shumë tryeza dhe karrike, nuk kishte pajisje shkollore të mjaftueshme, kushtet sanitare në shkollë ishin alarmuese".

Drejtori i shkollës fillore, për 800 nxënës por që ishte shkollë për dymbjesh nxënës, vetëm dy prej tyre ishin nga komuniteti jo Romë Maqedoni.

Raportet e vendeve *Pse të mohohet një e ardhme?* tregojnë se prindërit jo-Romë, Jevgjitë dhe Endacake ngurojnë të dergojnë fëmijët e tyre në shkollë ku ka fëmijë nga komunitetet Jevgjitë dhe Endacake. Një faktor tjetër është se në këto shkolla mbizoteron paragjykimi mbi bazën e perkatesisë etnike, gjithashtu shumë prindër e dinë se mesimi zhvillohet në kushte shumë të pafavorshme, nën standartin e duhur. Ka raste kur veprimi në formën e një investimi të lartë është i përfshirë në mesimdhënie dhe ka patur raste kur është tejkaluar çaku i paragjykimeve dhe nuancave negative nga ana e prindërve. Për shembull, duke investuar në një kopesht ku kryesisht ka fëmijë Romë dhe Jevgjitë, një Organizatë jo-qeveritare në Sllovaki ka arritur për një periudhë 10 vjeçare të tërheqë një numër të madh fëmijësh jo Romë. Për pasojë pengesat midis komuniteteve Romë dhe Jevgjitë dhe komuniteteve Sllovake, nuk janë kapercyer megjithatë ndarja në shkollat fillore gradualisht po ulët mëqë të dy komunitetet Romë, Jevgjitë, Sllovake po arrijnë në një tranzicion disi të suksesshem nga cikli parashkollor deri në klasën e parë. Asnjë fëmijë Romë ose Jevgjitë që ka ndjekur kopshtin nuk është dërguar në shkollë speciale këtu dy vitet e fundit. Në kohën që është shkruar raporti, u shfaqën disa shenja se politika dhe praktika e zhvilluar në këto shkollë model është adoptuar dhe nga tre kopshtë shtetërore që funksionojnë në këto zone. Qeveritë duhet të kenë parasysh të ndermarrin masa aktive në formën e politikave që të favorizojnë investime shumë të larta në arsimin e integruar dhe jo në arsimin e ndarë.

Agjensitë jo qeveritare kanë zhvilluar politike dhe praktike të mira. Agjensitë e qeverisjes lokale dhe agjensitë ndërkombëtare kanë treguar përgjegjësi për arsimin e hershëm dhe fillor dhe ato duhet të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për përfshirjen e këtyre praktikave dhe në shkollat shtetërore. Rezultatet e këtij investimi do të duken më vonë kur të shihet se të gjithë prindërit i konsiderojnë këto shkolla ku ka një numër të madh nxënësish Romë dhe Jevgjitë dhe shkollat speciale që janë për fëmijë Romë, Jevgjitë dhe Endacake me paafesi të theksuara.

Ekonomite ne tranzicion. A jane ndryshimet e qendrueshme?

Ne Evropen Qendrore dhe Juglindore vitet e fundit jane bere perpjekje te dukshme per te permiresuar kuadrin e pranimit te nxenesve si edhe cilesine e arritjeve te femijeve Rome dhe Jevgjite.

Ne shume vende keto iniciativa jane theksuar si projekte pilot ose eksperimentale. Vemendja ka qene e perqendruar ne disa iniciativa qe vinin nga jashte sistemit shkollor dhe jo nga ndryshimi i praktikave brenda vete sistemit. Ne kohen qe shkruhej raporti, ne Qershor te vitit 2001, shume iniciativa ne fushen arsimore te hartuar per femijet Rome dhe Jevgjite u financuan nga burime te jashtme(fonde nga Bashkimi Evropian, buxhet ndihmes nga qeverite e tjera, organizata bamiresie te huaja dhe kisha te huaja) . Keto iniciativa nuk u mbeshteten aq shume nga qeverite e vendeve ku ato ndodheshin . Nje interpretim dashakeq mund te tregonte se Romet vazhdonin te konsideroheshin si nje rast te cilet duhet te merrnin ndihma bamiresie nga jashte dhe jo nga qytetaret e vendit per te fituar nje trajtim te barabarte dhe mundesi te barabarta shkollimi. 90% e praktikës qe eshte raportuar dhe qe eshte mbeshtetur nga fonde afat-shkurtra nga agjensi donatore te huaja tregon se keto iniciativa do te rezultojne te suksesshme dhe jane te paevitueshme. Per shembull, ne procesin e perpilimit te raporteve ne gjetem disa materiale mesimore qe ishin pergatitur por nuk ishin shperndare dhe dokumentat tregonin se kishte disa mesues asistente Rome ishin trainuar por nuk ishin punesuar. Tani duket nje si deshtim, te mesosh nga projektet individuale per te krijuar bazen per nje reforme me te gjere. Pas disa dekadash, kur nuk ka patur investime te mjaftueshme ne arsim per femijet Rome dhe Cigane sepse arsimi i perjashtonte ata nga shumica, kostoja fillestare e sistemit ekzistues qe do te futet ne procesin e reformes, natyrisht qe do te jete i larte. Duke financuar projektet pilot per femijet Rome dhe Cigane disa agjensi donatore dhe organizata jo qeveritare nderkombetare, pa dashur mund te mbeshtesin ruajtjen e sistemit arsimor te ndare per keta femije nga femijet e tjere. Kerkesat per organizatat joqeveritare eshte tu tregojne rezultatet donatoreve brenda nje periudhe relativisht te shkurter per shume projekte qe jane hartuar per nje numer relativisht te vogel femijesh. Megjithate, pamvaresisht nga gjithe keto projekte gjendja nuk duket se ka ndryshuar shume per femijet Rome dhe Jevgjite ne strukturen dhe arsimin shteteror. Neqoftese politikat qe synojne reforma afat-gjata nuk mbeshteten me buxhete per ti vene ato ne jete progresi ne te ardhmen nuk do te ndryshoje shume nga ajo gjendje qe shfaqet sot me keto perpjekje jo strategjike dhe te pakordinuara mire.

Fondet qe merren nga jashte te dhena nga donatoret e huaj, padyshim qe kane luajtur nje rol jetesor ne nxitjen e politikave dhe kane bere te mundur testimin e skemave pilot dhe skemave eksperimentale. Mbeshtetja ne keto burime financimi per te ndihmuar arsimin per femijet Rome dhe Jevgjite eshte nje proces qe do te vazhdoje dhe eshte i pa kontestueshem. Donatoret nderkombetare, duhet te nxitin qeverite per te kuptuar se qytetaret nga minoriteti Rom dhe Jevgjit jane pjese e rendesishme e pergjegjesise se tyre.

Çfare do te ndodhte nese ndihma nga jashte do te nderpritej dhe pergjegjesia financiare per arsimin e minoriteteve Rome dhe Jevgjite do te binte perseri mbi qeverite.

- Duke patur parasysh mbeshitetjen nga financimet e jashtme, ndihet nje nevojje urgjente per nje vleresim realist te arsimit te reformuar i cili kerkon buxhete publike afatgjata. Ndihet nevojje e dukshme per te vleresuar ne menyre sa me reale se çfare duhet te arrijne burimet financiare per te kryer ndryshime ne fushen arsimore per femijet Rome dhe Jevgjite dhe ndersa kjo nevojje eshte urgjente, ndihet nje nevojje e ngutshme per te monitoruar rezultatet. Nje thenie e tille si " Qeveria X do te shpenxojë X dollare per iniciativat ne fushen arsimore per minoritetin Rom ne tre vitet e ardhme, mund te jete nje thenie e gabuar. Per shembull, ne raportet me titull pse te mohohet nje e ardhme shenohen shembuj ku nje numer i caktuar dollaresh iu eshte dhene shkollave ku femijet Rome dhe Jevgjite ndjekin shkollen me pagese per koke. Megjithate femijet ne keto shkolla nuk kane perfituar nga fondet shtese. Nje numer i madh nxenesish e lene shkollen. Femijet nuk e perfundojne shkollen me aftesite ose me kualifikimet e duhura. Ndersa ndihet nevojje per transparence persa i perket financimit ajo qe ka rendesi jane rezultatet qe arrijne femijet. Agjensite qeveritare, specialistet e arsimit dhe komunitetet Rome dhe Jevgjite duhet te gjejne menyra per te punuar sebashku, per te caktuar rezultatet qe ata shpresojne te arrijne, masat qe duhen marre per nje investim ose aktivitet te veçante qe do te sjelle keto rezultate dhe menytrat per te monitoruar dhe vleresuar nese permiresimet e projektuara kane ndodhur ose jo.
- Vazhdimesia e procesit ne periudhen post-komuniste: femijet Rome dhe Jevgjite ne shkollat speciale.

" Ata nuk i kuptojne pyetjet e testit dhe nuk kane etike pune. Per shembull, une pyes nje femije se çfare duhet te beje ai kur shikon se del tym nga nje shtepi. Pergjigja e drejte eshte se ai duhet te marre ne telefon brigaden e zjarrfiksave ose t'i thote ndonje me te rrituri. Femijet Rom si rregull, pergjigjen se soba duhet pastruar ose tubi i sobes duhet fiksuar mire qe tymi te dale jashte. Atehere une jam e detyruar t'i jap note negative ketij femije".

Psikolog, shkolle speciale - Serbi - ku 70% nga 250 femije jane Rome.

" Mesuesit nga shkollat speciale vine ketu çdo vjeshte dhe dalin ne ambientin rrotull duke u thene njerezve per ti derguar femijet atje pasi eshte nje shkolle me konvikt, nuk kane aresye te shqetesohen as per rrobat dhe as per ushqimin e tyre dhe me te varferit bien dakort se nuk kane çfare te bejne".

Studente Rome ne shkolle te pergjithshme- 14 vjeç Bullgari

Lexuesit qe e njohin mire Evropën qendrore dhe Juglindore padyshim qe do te habiten kur te lexojne kete dokument. Praktika e dergimit te mijra femijeve Rom dhe Jevgjit per tu shkolluar ne shkollat speciale per femijet me paaftesi mendore kur ne fakt ata nuk kane nje paaftesi te tille eshte ndoshta dukuria me ekstreme dhe me habitese e racizmit me te cilen ndeshen femijet Rome dhe Cigane ne disa pjese te Evropes. Megjithate kjo perfaqeson nje nga shume dukurite e ketij problemi, ne sistemet arsimore ne te gjithë Evropën. Shqetesimi yne eshte se duke u perqendruar kryesisht ne nje praktike qe prek disa vende, neve trajtojme nje problem qe eshte akoma me i thell ne te gjithë Evropën. Kudo qe ata ndodhen ne Evrope, femijet qe trajtohen si Jevgjite kane nje eksperience negative ne arsim dhe i nenshtrohen nje trajtimi diskriminues nga te gjithë antaret e tjere

te komunitetit. Ne disa vende qe nuk ka shkolla speciale dhunimet e te drejtave te ketyre femijeve jane me te sofistikuara.

- **Ne vendet ku vazhdon te praktikohet ndajrja e femijeve Rome dhe Jevgjite nga pjesa tjeter e femijeve nepermjet sistemit te shkollave speciale, qeverite kane per detyre te marrin masa urgjente qe t'i japin fund kesaj praktike. Ata duhet te vendosin si prioritare arsimin e mundshem dhe te integruar per te gjithë sipas konventes se UNESCO Kunder diskriminimit ne Arsim, Konventa e Kombeve te Bashkuara mbi te drejtat e femijeve dhe konventat e tjera kombetare dhe nderkombetare qe jane ratifikuar, nga shume shtete.**
- **Praktika e perdorimit te testeve te inteligjences IQ per te vleresuar aftesite e femijeve duhet te marre fund menjehere. Marreveshjet per financim, praktikat e menaxhimit dhe filozofia predominuese qe ka sjelle nje situatë ku stafi i shkollave speciale beson se eshte e pranueshme te rekrutohen femije nga komuniteti Rome dhe Jevgjite, te gjithë keto probleme duhen trajtuar me urgjencen e duhur.**
- **Duhen marre masa menjehere qe prinderit si edhe vete femijet te mos e pranojne diagnozen me titull nevoja te veçanta qe dalin nga zbatimi i testeve te inteligjences IQ.**
- Femijet qe jane diagnostikuar gabimisht me mangesi mendore dhe jane ne procesin e riintegrimin ne rrjedhen e shkolles duhet te kene mbeshtetje qe u nevoitet, per shembull mesimdhënie ekstra dhe ndihmese nga asistentet e klases, pa kosto ekstra per familjet e tyre.
- Shkollat, veçanerisht mesuesit, qe jane perfshire ne procesin e riintegrimin te femijeve nga shkolla te veçanta duhet te kene mundesi ne mbeshtetje profesionale shtojce, per ti mundesuar ato te menaxhojne kalimin e lehte te femijeve.

Konkluzione dhe hapa te metejshme

Sherbimet arsimore te siguruara falas nga shteti mund te kompensojne pjeserisht per disavantazhet dhe pabarazite qe mund te lindin nga varferia apo rrethana te veshtira familjare. Ato jane gjithashtu nje mjet i rendesishem i nxitjes se respektit, nga nje moshe e vogel, per qytetare me prejardhje te ndryshme kulturore, gjuhësore, fetare dhe etnike.

Ne te gjithë Evropën, ekzistojne ndryshime midis te drejtave ligjore te femijeve sikurse ato jane te shprehura ne ligjin nderkombetar dhe kombetar dhe politika dhe eksperiencia te femijeve Rom, Jevgjite dhe Endacake ne shkolla. Raporti *Nje e ardhme e mohuar ?* tregon se kjo ka te beje me barrierat politike, ekonomike dhe kulturore. Ne veçanti, pozicioni i arsimit ne prioritetet shoqerore, kulturore dhe ekonomike te shtetit mund te bejne kompromis me te drejtat arsimore te femijeve Rom, Jevgjite apo Endacake ose t'i nxisin ata.

Save the Children pershendet perpjekjet nga ana e disa qeverive per te kuptuar me mire dhe per te adresuar barrierat qe pengojne femijet Rom, Jevgjite dhe Endacake per te perdorur plotesisht dhe per te perfitur nga sigurimet arsimore ne vendet ku ato jane qytetare. Interesi i qendrushem, bashkepunimi i permiresuar dhe nje metode kohezive

nga ana e agjensive nderqeveritare jane te rendesishme ne mbeshtejten qe i duhet dhene qeverive ne keto perpjekje.

- Save the Children rekomandon se kerkime te metejshme, si sasiore dhe cilesore, duhet te ndermerren ne sigurimin e nje te kuptuari me te mire :
 - si gjinia ndikon ne aspiratat arsimore, veçanerisht tek femijet e gjinise femerore por gjithashtu tek femijet meshkuj qe largohen nga shkolla me statusin “e te rriturit”,
 - perceptimet e familjeve, perfshire perceptimet e femijeve, te “kostos se mundesive” te arsimit krahasuar me benefitet e kontributit ne jeten e familjeve, duke punuar apo siguruar perkujdesje per femije
 - nevojat e veçanta te te rinjve qe jane prinder
 - Sfidat e veçanta shoqeruar me plotesimin e nevojave te femijeve qe jane foles vendas te gjuhes Rome apo nje prej dialekteve te saj
 - Ekzistenca e tregut te punes, diskriminimi dhe efektet e tij ne rezultatet e pritshme arsimore dhe te karrieres dhe aspiratat e femijeve Rom, Jevgjite dhe Endacake.
 - Aspekthe specifike te sigurimeve me baze shkolle qe prinderit Roma, Jevgjite dhe Endacake i konsiderojne si “asimiluese” dhe per rrjedhoje te padasherueshme per femijet e tyre.
 - Aspekthe specifike te sigurimeve me baze shkolle qe minojne besimin qe prinderit Rom, Jevgjite dhe Endacake kane tek shkolla dhe besimin e tyre ne dobine dhe perkatesine e sigurimeve arsimore me baze shkolle.

Ne lidhje me rekomandimet e mesiperme, Save the children propozon qe aspekthe te sigurimeve te meposhteme te monitorohen ne periudhen e ardhshme 5-10 vjeçare me qellim qe te vleresoje efektivitetin e masave qe jane propozuar dhe ndermarre nga institucionet nderqeveritare dhe qeveritare:

- permbajtja e trainimit te mesuesve lidhur me mesuesit qe perfitojne aftesi te nevojshme ne pune me femijet me prejardhje te ndryshme perfshire femijet Rom, Jevgjite dhe Endacake.
- Mundesia e perdorimit, perhapja dhe permbajtja e kurrikules, tekstet shkollore dhe burime mesimdhense lidhur me perfshirjen e referencave per femijet Rome, Jevgjite dhe Endacake
- Mundesia e perdorimit te burimeve (tekste dhe materiale mesimore) ne gjuhen Rome per perdorim nga mesuesit dhe studentet
- Cilesia dhe kushtet materiale te lehtesirave te mundshme per shkollimin e femijeve Rom, Jevgjite dhe Endacake ne mjediset ku ka shume popullsi Rome, Jevgjite dhe Endacake ne krahasim me lehtesirat qe ofrohen per shumicen e femijeve
- Evidentimi i njerezve Rom, Jevgjite dhe Endacake ne profesione mesimdhenie dhe profesione te tjera shoqeruar me arsimimin e tyre
- Roli, numri dhe statusi profesional i asistencave te klasave ne klasat ku ka femije Rome, Jevgjite dhe Endacake
- Perceptimet e prinderve dhe femijeve per sigurine e mjediseve shkollore, perfshire dhe udhetimin vajtje-ardhje ne shkolle, me rezikun qe femija t’i nenshtrohet abuzimit verbal apo fizik

- Kostoja aktuale e nje familjeje qe ka nje femije qe ndjek arsimim “te lire”
- Mundesia dhe kostoja e kushteve per parashkollorin dhe kopshtet
- Numri i femijeve Rom, Jevgjite dhe Endacake qe ndjekin “shkolla te veçanta” dhe ambinete te tjera ku atyre u mungojne te drejtat e tyre dhe kriteret dhe proceset sipas te cilave femijet rregjistrohen ne ambiente te tilla
- Numri i femijeve Rom, Jevgjite dhe Endacake qe kryejne arsimin baze dhe mundesi te tjera punesimi kur ata e kryejne arsimin baze krahasuar me grupe te tjera
- Numri i te rinjve Rom, Jevgjite dhe Endacake qe kane perfunduar arsim te metejshem dhe arsimin e larte, numri i atyre qe synojne per shkolla profesionale apo akademike dhe mundesite e tyre per punesim kur perfundojne studimet e tyre krahasuar me grupe te tjera.
- Mundesia dhe efektiviteti i mundesive jasht shkollore dhe suplementare perfshire dhe krijimin e kushteve per punetore sezonale, klasa gjuhe suplementare, klube shtepiake, kurse per femije dhe te rritur qe ri-futen ne arsim, arsimimi i te rriturve dhe klasat e mbremjes.
- Burime te financimit per arsimin e femijeve Rom, Jevgjite dhe Endacake sipas ndarjeve perkatese nga qeveria dhe burimeve te jashtme ne financimin e sherbimeve arsimore.
- Shkalla ne te cilen sigurimi per femijet minoritare Rom, Jevgjite dhe Endacake lejohet te futet ne rrjedhen e pergjithshme me kalimin e kohes ne politikat dhe buxhetet arsimore kombetare.